



Joniada Goçaj

Drejtor

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Znj. Joniada Goçaj ka përfunduar studimet e larta të nivelit “Master Shkencor”, në degën Financë, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2010 është diplomuar në Master të Nivelit të Dytë, Politikë e Jashtme & Diplomaci dhe në vitin 2018 është diplomuar në degën Drejtësi, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Për periudhën 2023 – 2024 është diplomuar në lidhje me programin e specializuar të trajnimit të ofruar nga CEF (Center of Excellence in Finance) në bashkëpunim me CIPFA (Chartered Institute of Public Finance and Accountancy), i fokusuar në ngritjen e kapaciteteve për auditimin e brendshëm në sektorin publik. Në funksion të ushtrimit të profesionit disponon licensën profesionale të Vlerësuesit të Pasurive të Paluajtshme.

Në periudhën 2007–2014, znj. Goçaj ka punuar në sektorin privat, në pozicionin financiere. Znj. Goçaj ka filluar punë në KLSH në tetor të vitit 2014, ku ka mbajtur pozicione të ndryshme si Auditues i Parë, Auditues i Lartë dhe Kryeauditueses, si dhe ka qenë e angazhuar në të gjitha Departamentet e Auditimit, duke krijuar një eksperiencë dhe përvojë në auditim në të gjithë sektorët e administratës publike.

Aktualisht është në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve.

Znj. Goçaj është e angazhuar edhe si pedagoge e jashtme për lëndën “Statistikë”, pranë Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.


Gjatë karrierës së saj ka ndjekur disa trajnime të rëndësishme ndërkombëtare për rritjen e kapacitetit profesional si:


Në vitin 2019, ka ndjekur programin 5 mujor të “Internship-it” në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), në Luksemburg, ku ka qenë pjesë e Departamentit të Financimit dhe Administrimit të Unionit (Chamber V: Financing and Administering the Union). Gjithashtu, në vijimësi ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në tema që lidhen me auditimin e jashtëm.


Znj. Goçaj është njohëse e gjuhës angleze dhe gjuhës italiane.



Kontakt

 jgocaj@klsh.org.al

 Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë,
Shqipëri

 www.klsh.org.al